

RAPORT MBI AKTIVITETIN E SHOQATËS GJEOTEKNIKE TE SHQIPËRISË PËR VITIN 2015

Gjatë vitit 2015 Shoqata Gjeoteknikët e Shqipërisë ka patur një aktivitet shumë të gjerë. Më poshtë po i rendisim aktivitetet me rradhë.

1- Gjatë vitit 2015 SH.GJ.SH. ka zhvilluar një aktivitet shumë të rëndësishëm ndërkombëtar: Konferencen Europiane “Gjeomjedisi dhe Ndërtimi”. Kjo Konferencë hyri në aktivitetin e Shoqatës Botërore ISSMGE, dhe ishte mjaft e rëndësishme për arsyet e mëposhtme:

- Pjesëmarrjen në të të Presidentit të ISSMGE Prof. Roger Frank, Zëvendës Presidentit të ISSMGE për Europën Prof. Antonio Gens dhe për Afrikën Prof. Fatma Baligh.
- Pjesëmarrjen e profesorëve dhe personaliteteve të shquara të Europës në fushën e gjeoteknikës si Profesorët :Heinz Brandl, Dietmar Adam, Antonio Gomes Correia, Rolf Katzenbach, Janko Logar, Ivan Vanicek, Andrea Anagnostopoulos, George Belokas, Lida Miraj , Lindita Këllezi etj.
- Pjesëmarrje të madhe ku me abstrakte u paraqitën 162 autorë nga 28 vënde të botës (Europës, Azisë, Afrikës), dhe me punime 138 autorë nga 22 vënde .
- Pëe faktin që 40% e punimeve të Konferencës ishin përgatitur nga autorë shqiptarë, gjë që tregoi se edhe në Shqipëri bëhet kërkim shkencor dhe me nivel te mirë , të vlerësuar nga personalitetet e huaja.
- Gati 50% e anëtarëve të SH.GJ.SH. (14 anëtarë të saj)paraqitën punime mjaft dinjitoze dhe me probleme gjeoteknike , mjedisore etj që shqetësojnë vendin.
- Niveli i leksioneve dhe i prezantimeve ishte shumë i mirë, dhe organizimi i sesionit me postera (12 të tillë) gjithashtu.
- Niveli i botimit të punimeve të Konferencës ishte gjithashtu shumë i mirë.
- Organizimi i gjithë Konferencës : sesionet e diskutimeve, ekspozita , vizita teknike, recepsioni i mirësearchjes dhe darka gala ishin të persosura sipas opinionit të gjithë pjesëmarrësve sidomos të profesorëve të huaj, të cilët u shprehën me fjalët më te mira për nivelin, organizimin e Konferencës dhe mikëpritjen tonë.

Kjo Konferencë u realizua në bashkëpunim me ISSMGE dhe me Universitetin Polis. Të gjithë anëtarët e SH.GJ.SH. dhanë kontributin e tyre sipas mundësive, por vecanërisht u dalluan Erion Bukaci, Egi Bozo

dhe Erdi Myftaraga, të cilët përballuan ngarkesën më të madhe të këtij eventi të rëndësishëm e të vështirë. Kryetare e Komitetit Organizator dhe atij Shkencor ishte Prof.Luljeta Bozo.

- 2- Gjatë gjithë vitit ka funksionuar faqja jonë e internetit, e cila furnizon me informacion cilindo që është i interesuar për veprimtarinë e SH.GJ.SH.
- 3- Doli revista vjetore Nr 16. Revista “Gjeoteknika” doli si botim i vecantë me punimet e e anëtarëve të SH.GJ.SH ne Konferencën Europiane “Gjeomjedisi dh Ndërtimi”
- 4- Anëtarët e SH.GJ.SH. morrën pjesë në Konferencën e XVI të ISSMGE për Europën që u mbajt në Shtator në Edinburg.Aty u paraqitën me punimet e tyre : L.Bozo, S.Allkja, L.Harizaj, A.Kosho, A.Malaj, E.Bozo, E Kalluci.Prof. Luljeta Bozo ishte anëtare e Komitetit Shkencor te kësaj Konference dhe drejtoi seancën”F” të diskutimeve në këtë event.
- 5- Anëtarë të SH.GJ.SH. morren pjesë ne Konferencën e I Ndërkombëtare të Shkencave të Aplikuara që u mbajt në Maqedoni, ku Prof. Luljeta Bozo ishte në Komitetin Shkencor të Kësaj Konference dhe lektore e ftuar, kurse Eglja Lica u paraqit me punim.
- 6- SH.GJ.SH. ishte bashkëorganizatore e Kongresit te II Ndërkombëtar të Rrugëve të Shqipërisë. Në këtë Kongres Prof. Luljeta Bozo ishte Kryetare e Komitetit Shkencor të tij . Neë këtë event u paraqitën me punimet e tyre S.Allkja, E Paci, K.Cela, L.Harizaj, A.Malaj, B.Xhagolli, E.Kalluci, I Rusi.
- 7- Nën drejtimin e K.Celës dhe grupit të tij doli nga botimi nje libër mjaft i mirë “Projektimi i rrugëve dhe siguria rrugore”, që do ti shërbejë inxhinuerëve që punojnë në sektorin e transportit.
- 8- Janë duke punuar për përgatitjen e doktoraturës anetarët e SH.GJ.SH. : Erion Bukaci, Laureta Sharra, Eglja Luca , dhe e ka dorëzuar në Këshillin Shkencor të FIN dosjen e kompletuar Merita Guri, e cila është në pritje të mbrojtjes para jurisë.
- 9- SH.GJ.SH. mban lidhje të ngushta dhe bashkëpunon me shoqatat e shteteve fqinje si dhe me ISSMGE dhe ISRM.
- 10- Në SH.GJ.SH janë rregjistruar 4 anëtarë të rinj nga të cilët:
 - Eglantina Disha vazhdon Master Profesional në Planifikim dhe Menaxhim Urban e Mjedisor
 - Vasil Sterjo vazhdon Master Profesional në GIS
 - Mentor Kajnozi
 - Përparim Kajnozi

11 - Këtë vit përbërja e SH.GJ.SH. është si vijon:

- Në fund të Janarit 2016 në shoqatë marrin pjesë 33 anëtare
- Kualifikimi shkencor i tyre është : 1 profesor, 5 doktora shkencash, 4 doktora shkencash në punë e sipër, 23 mastera shkencor.
- Sipas gjinisë në shoqatë kemi 19 vajza dhe gra ,ose gati 57% e numurit të përgjithshëm
- Sipas profesioneve kemi :4 gjeologë, 1 planifikues urban, 28 inxhinierë ndërtimi, gjeoteknikë, hidroteknikë.

Sikurse shihet shoqata jonë është rritur në numur , ne cilësi, dhe në pjesëmarrje ne aktivitete të ndryshme shkencore brenda dhe jasht vendit.

Problemet që kemi patur gjatë vitit 2015 kanë qenë :

- Mos pagesa e kuotës së anëtarimit
- Duhet pjesëmarrje më e madhe në aktivitetet e Shoqatës
- Më shumë duhet të informojë secili për arritjet e tij, ose të fushës apo sektorit ku ai/ajo punon, në mënyrë që këto të pasqyrohen në faqen tonë të internetit.
- Më shumë duhet shkruar për revistën tonë.

RAPORT MBI GJENDJEN FINANCIARE TE SH.GJ.SH. PËR VITIN 2015

Gjatë vitit 2015 të ardhurat e Shoqatës Gjeoteknikët e Shqipërisë kanë qenë vetëm nga kuotat e anëtarëve të saj . Shpenzimet kanë qenë kryesisht për të paguar kuotën si anëtarë të ISSMGE dhe të ISRM, si dhe për disa printime e kancelari Në vijim jepen të gjitha këto të detajuara

Të ardhura :

1- Të mbartura nga viti 2014	308095	lekë
2- Nga kuotat e anëtarëve ne SH.GJ.SH.	125000	“
3- Nga kuotat për anëtarësimin në ISRM	8928	“
Gjithsej të ardhura	442023	“

Shpenzime :

1- Pagesa e kuotës vjetore për anëtarësim në ISSMGE	74108	lekë
2- Pagesa për komision bankës Raiffeisen	2674	“
3- Pagesa për anëtarësimin në ISRM	20925	“
4- Pagesa për faqen e internetit të SH.GJ.SH	14000	“
5- Shumëfishim i buletinit informativ me ngjyra(50 copë)	5000	“
6- Printim i materialeve shkencore të Konferencës	1500	“
7- Shpenzime kancelarie(letër,postime,qese plastike etj)	1000	“
Gjithsej	119207	“

Bilanci :

Të ardhura 442023 lekë

Teprica 322816 “

PLANI I AKTIVITETEVE PËR VITIN 2016

- 1- Të ushqehet vazhdimisht me informacion të ri faqja jonë e internetit
- 2- Të organizojmë një kurs formimi me temë: “Ndërtimi dhe problemet mjedisore sidomos në H/C, rrugër, ndërtimit në qytetet e mëdha”
- 3- Pjesëmarrje në aktivitete ndërkombëtare (konferenca shkencore) në Napoli (Itali), Minho (Portugali), Australi.
- 4- Të nxirren dy revista Gjeoteknika Nr. 17 me aktivitetet e rubrikat e nevojshme për vitin 2015, dhe Gjeoteknika Nr. 18 me rubrikat dhe aktivitetet e vitit 2016.
- 5- Përgatitje me punime për KONGRESIN botëror të ISSMGE që do të mbahet në Seul më 2017 (1 punim nga të rinjt dhe një punim nga antarët me eksperiencë).
- 6- Të paguhen kuotat për antarsim në ISSMGE dhe në ISRM.
- 7- Të organizojmë një leksion të hapur për teknologjitë e reja të përdorura në Tiranë për ndërtimin e pjesës nëntokësore të një objekti shumë katësh.
- 8- Të festojmë ditëlindjet jubilarë të anëtarëve të Shoqatës.

Përgatitur nga Prof. Dr. Luljeta Bozo dhe miratuar

në mbledhjen e Shoqatës me 12 02 2016

LISTA E ANËTARËVE TË SHOQATËS GJEOTËKNIKËT E SHQIPËRISË PËR VITIN 2016

- 1- Ago Besnik
- 2- Allkja Skënder
- 3- Blliku Eduard
- 4- Bozo Egi
- 5- Bozo Luljeta
- 6- Bukaci Erion
- 7- Çela Kujtim
- 8- Disha Eglantina
- 9- Doda Enver
- 10- Dhimitri Luisa
- 11- Goxhaj Elona
- 12- Goga Kristo
- 13- Guri Merita
- 14- Harizaj Lorena
- 15- Kadare Ira
- 16- Kalluci Evjena
- 17- Kajnozi Përparim
- 18- Kajnozi Mentor
- 19- Keri Elenika
- 20- Këllezi Lindita
- 21- Koreta Olsi
- 22- Kosho Ani
- 23- Luca Egla

24- Malaj Ardita

25- Mata Elona

26- Myftaraga Erdi

27- Paçi Ervin

28- Qerama Eglantina

29- Rusi Ilda

30- Sterjo Vasil

31- Sharra Laureta

32- Xhagolli Besian

33- Xhemalaj Esida